

KOMONUELTHI I PENSILVANISE
KOMISIONI I PENSILVANISË PËR KRIMET DHE KUNDRAVAJTJET

Mesazh i Rëndësishëm i Avokatit për Shkollat e Sigurta

I dashur Prind/Kujdestar,

Me anën e kësaj letre ju njoftojmë se Avokati i Shkollave të Sigurta, ka marrë dijeni, që fëmija juaj mund të ketë qenë viktimë e dhunës në shkollë, ose në mjediset pranë saj. Si rrjedhojë, Zyra e Avokatit të Shkollave të Sigurta, ju ofron asistencën e saj. Si një prind/kujdestar, ju keni të drejtën të keni avokat:

- 1) Në seancën dëgjimore disiplinore, që thirret me kërkesën tuaj. Gjatë seancës, Avokati mund të paraqesë informacion/dëshmi dhe dëshmitarë të rastit
- 2) Ofron asistencë dhe këshilla, në shërbimet mbështetëse, që ofrohen për viktimën;
- 3) Ofron informacion për procesin disiplinor dhe rezultatin e tij;
- 4) Ofron informacion nëse Drejtoria Arsimore ka vepruar siç duhet, kur rasti në fjalë përfshin armët;
- 5) Asiston që viktima të jetë i sigurtë në mjediset që i përkasin shkollës;
- 6) Bën raportet për policinë në rast se këto nuk janë kryer nga drejtoria arsimore;
- 7) Ofron informacion dhe rekomandime për Prokurorin e Distriktit, në lidhje me pasojat e incidentit tek viktima dhe familja e viktimës.

Si avokat, Unë dua të sigurohem që ju jeni i njohur me faktin që Zyra e Avokatit të Shkollave të Sigurta, është e gatëshme për ndihmë. Personeli i Zyrës dhe Unë, jemi të përkushtuar që t'ju ofrojmë ju dhe fëmijës tuaj, mbështetje dhe asistencë. Zyra jonë ndodhet në Qendrën Mësimore të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, me adresë **440 N. Broad Street in Suite 1198**. Orari i punës së Zyrës është **8:30am-5:00pm** dhe numri i telefonit **215-656-5381**, ose mbas orarit të punës në linjën 24-orëshe **1-877-730-6315**.

Sinqerisht,

Kelley B. Hodge, Esq.
Avokat i Shkollave të Sigurta